



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:231158
Datë: 24.09.2024
Numri i dokumentit: 06200467

Pml.nr.520/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit V. D., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, nr.2023:231158 të datës 16.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 5 shtator 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit V. D., anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm nr.2023:231158 i datës 16.04.2024 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin nr.2023:231158 e datës 16.04.2024, të dënuarin V. D. e ka shpallur *fajtor* për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €. I dënuari është obliguar në pagesën prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 20 €, në fondin e kompensimit të viktimave.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtij aktgjykimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Mentor Neziri nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për sanksionin penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshoj kualifikimin juridik të veprës penale dhe të dënuarin të e shpall fajtor për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së dhe të i shqipton dënim me gjobë, ose anuloj aktgjykimin e kundërshtuar dhe çështjen të e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.302/2024 e datës 03.09.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe si pasojë e kësaj shkelje duhet anuluar aktgjykimi i kundërshtuara. Kjo për faktin se gjatë seancës fillestare në të cilën i dënuari ka pranuar fajësinë del se i njëjti fajësinë e ka pranuar për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, kurse është shpallur fajtor për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, andaj, aktgjykimi si tërësi është i paqartë dhe kundërthënës me procesverbalin e shqyrtimit fillestar, përkatësisht pranimin e fajësisë nga ana e të dënuarit.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se janë të bazuara pretendimet e paraqitura se gjatë procedurës penale është shkelur dispozita e procedurës penale nga neni 384 par.2 nënpar.2. të KPP-së, pasi që gabimisht është zbatuar dispozita e nenit 242 par.2 të KPP-së.

Bazuar në shkresat e lëndës dhe posaçërisht procesverbali i shqyrtimit fillestar del se i dënuari kishte bërë pranimin e fajësisë dhe pas konstatimit se janë plotësuar kriteret e pranimit të fajësisë sipas nenit 242 të KPP-së, dhe ishte vazhduar me shqiptimin e dënimit. Kurse me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ishte konstatuar fakti se në rastin konkret ishin plotësuar kriteret për pranimin e fajësisë të përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPP-së, mirëpo me këtë rast sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e pranimit të fajësisë nuk ishin plotësuar kriteret e kërkuara ligjore. Dispozita e nenit 242 par.2 të KPP-së ka përcaktuar se: *“Kur i akuzuari pranon fajësinë për secilën ose disa pika të aktakuzës sipas nenit 241 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse: 2.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; 2.2. pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me avokatin mbrojtës, nëse i akuzuari ka mbrojtës dhe pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, përveç premtimeve të cekura në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë sipas nenit 230 të këtij kodi; 2.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i akuzuari; dhe 2.4. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.”.*

Nga leximi i dispozitës ligjore nënkuptohet se për tu bërë pranimi i fajësisë të gjitha kriteret duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe në të kundërtën, pranimi i fajësisë nuk do të ishte në harmoni me dispozitën ligjore. Kurse në rastin konkret nga përmbajtja e dispozitivit të

aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, rrjedh se i dënuari ishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, mirëpo nga procesverbali i shqyrtimit fillestar të datës 16.04.2024 del se i dënuari ishte deklaruar fajtor për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Nga kjo rrjedh se i dënuari është deklaruar fajtor për vepër tjetër penale në raport me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është gjykuar, pra është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë që pranimin e fajësisë ta vlerësoj në dritën e dispozitës ligjore të nenit 242 par.2 të KPP-së, përndryshe bie ndesh me dispozitën e mësipërme ligjore, si dhe provave të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj çështje penale, siç ka ndodhur në rastin konkret.

Nga të gjitha këto, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2, nënpar.2. të KPP-së, dhe me këtë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar, që rezultoi me marrjen e vendimit për anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe shqyrtim të serishëm të kësaj çështje.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet që të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.520/2024, më 5 shtator 2024

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala